

# AKT THEMELIMI

## I


### SHOQËRISË TREGTARE

“General Cement Albania” Sh.p.k

Ky akt themelimi përpilohet nga ortaku i vetëm themelues:

Shoqëria “GENERAL CEMENT” SPA, me qendër në Milano, 20123, Itali, me adresë Via Privata Maria Teresa 11 dhe kapital themeltar 200.000 (dyqindmijë) Euro.

I quajtur më poshtë “Ortak Themelues”, në përputhje me ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar” vendosi të hartojë aktin themelues si vijon:



#### Neni 1 - Forma dhe emërtimi i shoqërisë

Ortaku themelues formon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me Ortak të Vetëm, në përputhje me ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar”

Emërtimi i shoqërisë do të jetë: **“GENERAL CEMENT ALBANIA” SH.P.K**

Shoqëria me këtë emër do të ketë vulën e saj. Në çdo akt të lëshuar nga shoqëria, është e detyrueshme të deklarohen inicialet “sh.p.k.” (që përfaqësojnë formën e shoqërisë).

#### Neni 2 - Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në qytetin Tiranë, Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall. 26/1

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakut të Vetëm.

Shoqëria mund të ketë, filiale, dhe përfaqësi të saj edhe në rrethe të tjera të territorit të Shqipërisë dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente.

#### Neni 3 - Kohëzgjatja

Shoqëria “GENERAL CEMENT ALBANIA” Sh.p.k. ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike deri në 31 dhjetor 2050

#### Neni 4 - Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

a) prodhimin dhe tregtimin e çimentove, gëlqereve, të lidhësve hidraulikë, të shtesave minerale natyrale dhe artificiale, të konglomeratëve të çementuar të parakonfeksionuar, të elementëve të parafabrikuar në beton të çdo lloji, të llaçi stabilizues, të parapërzier, të

konglomeratëve bituminozë dhe të materialeve të ndërtimit të çdo lloji, të inerteve dhe të agregatëve të çdo lloji për beton dhe aplikime të tjera në ndërtim; blerja dhe menaxhimi i gurorëve dhe minierave të çdo lloji, përfshirë kultivimin me anë të blerjes dhe përdorimit të materialit shpërthyes;

b) prodhimi, tregtimi, furnizimi, për llogari të vetën dhe të të tretëve, dhe vënia në punë eventuale e prodhimeve të llojit të ndryshëm për ndërtim dhe mbrojtjen e strukturave në çimento arme dhe metal;

c) prodhimi, tregtimi, furnizimi, për llogari të vetën dhe të të tretëve, të prodhimeve kimike për ndërtim si shtues të çimentos, betonit, llaçit të parapërzier, bojtrave të vajiti, lidhësve hidralulikë, shtresave mbrojtëse dhe të ngjashme;

d) marrja pjesë dhe interesimi në shoqëri, ente, konsorciume dhe shoqata si shqiptare ashtu dhe të huaja, vetëm me qëllim të investimi të qëndrueshëm dhe jo ndaj publikut, operues në sektorë për të cilat pikat më lartë ose të ngjashëm me të;

e) koordinimin e çdo lloji në sektorët ekonomikë, tregtarë, administrativë të veprimtarive të sipërmarrjeve në të cilat merr pjesë;

f) ushtrimi, në rrugë jo prevalente dhe ekskluzivisht ndaj shoqërive kontrolluese, të kontrolluara ose të lidhura sipas legjislacionit shqiptar në fuqi ose të shoqërive të kontrolluara nga vetë kontrolluesja, pra të shoqërive operuese në të njëjtin grup, të veprimtarive të mëposhtme:

\* dhënia e financimeve nën çdo formë;

\* dhënia e dorëzave, barrave, garancive hipotekore;

\* shërbime i marrjes së pagesave, pagesave dhe transferimit të fondeve;

\* transmetimi ose ekzekutimi i urdhër-pagesave, edhe nëpërmjet debitimit ose akredimitimit, të kryer nën çdo formalitet;

\* kompensimi i debiteve dhe krediteve;

Shoqëria në rrugë instrumentale, jo prevalente dhe jo ndaj publikut, mund të kryejë çdo operacion tregtar, industrial, financiar, mobiluar dhe imobiliar, që do të konsiderohet nga organi administrativ i nevojshëm dhe dobishëm për arritjen e objektit shoqëror.

## **Neni 5 - Kapitali themeltar i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “GENERAL CEMENT ALBANIA” SHPK është 2.000.000 (dy milionë) Lekë, i gjithi i nënshkruar dhe shlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë

Pronar i vetëm i kapitalit themeltar të shoqërisë, është shoqëria “GENERAL CEMENT” SPA, me qendër në Milano, 11, 20123, Itali, me adresë Via Privata Maria Teresa 11 dhe kapital themeltar 200.000 (dyqindmijë) Euro,

Kapitali i shoqërisë “GENERAL CEMENT ALBANIA” SHPK ndahet në 2.000 (dy mijë) kuota me vlerë 1.000 (një mijë) lekë secila.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë përgjigjet për humbjet e shoqërisë në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

## **Neni 6 - Organet drejtuese**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve/Ortak i Vetëm
2. Administratorët e shoqërisë:

### Neni 7 – Emërimi i administratorëve

Emërohen me këtë Akt Themelimi si administratorë të shoqërisë

Z. Mana Mauro, i lindur në Cavallermaggiore, më 3 shkurt 1945, banues në Cavallermaggiore, Via delle Antiche Mura 21, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr 498537 Z;

Z. Gianfranco Tonon, i lindur në Colle Umberto, më 8 janar 1951, banues në Colle Umberto (TV), Via dei Fioretti 17, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. Y438674;

3. Z. Leonardo Acti, i lindur në Rossano (Bologna), më 15 janar 1951, banues në Via Domenico Aimò nr.2, Bologna, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. B 149276;
4. Z. Michele Valente, i lindur në Foggia, më 15 shkurt 1945, banues në Treviso, Vicolo Duomo nr. 3, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. B 283677;

### Neni 8 – Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar

Emërohet si esperte e parë kontabël e shoqërisë Znj. Shpresa Berçani, me liçencë nr. 143, lëshuar më 29.12.2006.

### Neni 9 - Ndërtimi dhe organizimi i veprimtarisë

Ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i “**GENERAL CEMENT ALBANIA**” SHPK. zhvillohen sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, në bazë të statutit dhe të këtij akti themelimi.

### Neni 10 - Dispozitë kalimtare


Ky Akt Themelimi redaktohet në pesë kopje origjinale.  
Pjesë përbërëse e Aktit të Themelimit është Statuti i shoqërisë.

### THEMELUESIT

Ortaku i vetëm  
Shoqëria “General Cement” s.p.a

Përfaqësuar nga

**z. Michele Valente**



**(Administrator i deleguar)**

## STATUTI

### I

## SHOQËRISË TREGTARE

“General Cement Albania” Sh.p.k.



### Neni 1

## KRIJIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “GENERAL CEMENT ALBANIA” SHPK krijohet në bazë të aktit të themelimit datë 30/03/2007 nga ortakutë të vetëm, që është shoqëria “GENERAL CEMENT” Spa, me qendër në Milano, në Via Privata Maria Teresa 11, 20123, Itali.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet e Aktit të Themelimit dhe Statutit.

### Neni 2

## FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria “GENERAL CEMENT ALBANIA” SHPK. krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me Ortak të Vetëm dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr 7638 dt 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

### Neni 3

## EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i Shoqërisë është: “GENERAL CEMENT ALBANIA” SHPK.

### Neni 4

## SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë “GENERAL CEMENT ALBANIA” Sh.p.k. është në Tiranë në adresën: Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall. 26/1, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me Vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

Shoqëria mund të ketë filiale dhe përfaqësi të saj edhe në rrethe të tjera të territorit të Shqipërisë dhe jashtë territorit të Shqipërisë me miratimin e organeve kompetente.

## **Neni 5 KOHËZGJATJA**

Shoqëria "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK. ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike deri në 31 dhjetor 2050.

## **Neni 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- a) prodhimin dhe tregtimin e çimentove, gëlqereve, të lidhësve hidraulikë, të shtesave minerale natyrale dhe artificiale, të konglomeratëve të çementuar të parakonfeksionuar, të elementëve të parafabrikuar në beton të çdo lloji, të llaçi stabilizues, të parapërzier, të konglomeratëve bituminozë dhe të materialeve të ndërtimit të çdo lloji, të inerteve dhe të agregatëve të çdo lloji për beton dhe aplikime të tjera në ndërtim; blerja dhe menaxhimi i guroreve dhe minierave të çdo lloji, përfshirë kultivimin me anë të blerjes dhe përdorimit të materialit shpërthyes;
  - b) prodhimi, tregtimi, furnizimi, për llogari të vetën dhe të të tretëve, dhe vënia në punë eventuale e prodhimeve të llojit të ndryshëm për ndërtim dhe mbrojtjen e strukturave në çimento arme dhe metal;
  - c) prodhimi, tregtimi, furnizimi, për llogari të vetën dhe të të tretëve, të prodhimeve kimike për ndërtim si shtues të çimentos, betonit, llaçit të parapërzier, bojrave të vajiti, lidhësve hidraulikë, shtresave mbrojtëse dhe të ngjashme;
  - d) marrja pjesë dhe interesimi në shoqëri, ente, konsorciume dhe shoqata si shqiptare ashtu dhe të huaja, vetëm me qëllim të investimi të qëndrueshëm dhe jo ndaj publikut, operues në sektorë për të cilat pikat më lartë ose të ngjashëm me të;
  - e) koordinimin e çdo lloji në sektorët ekonomikë, tregtarë, administrativë të veprimtarive të sipërmarrjeve në të cilat merr pjesë;
  - f) ushtrimi, në rrugë jo prevalente dhe ekskluzivisht ndaj shoqërive kontrolluese, të kontrolluara ose të lidhura sipas legjislacionit shqiptar në fuqi ose të shoqërive të kontrolluara nga vetë kontrolluesja, pra të shoqërive operuese në të njëjtin grup, të veprimtarive të mëposhtme:
    - \* dhënia e financimeve nën çdo formë;
    - \* dhënia e dorëzanive, barrave, garancive hipotekore;
    - \* shërbime i marrjes së pagesave, pagesave dhe transferimit të fondeve;
    - \* transmetimi ose ekzekutimi i urdhër-pagesave, edhe nëpërmjet debitimit ose akreditimit, të kryer nën çdo formalitet;
    - \* kompensimi i debiteve dhe krediteve;
- Shoqëria në rrugë instrumentale, jo prevalente dhe jo ndaj publikut, mund të kryejë çdo operacion tregtar, industrial, financiar, mobiluar dhe imobiliar, që do të konsiderohet nga organi administrativ i nevojshëm dhe dobishëm për arritjen e objektit shoqëror.

## **Neni 7**

## KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare "GENERAL CEMENT ALBANIA" Sh.p.k. është 2.000.000 (dy milionë) Lekë, i nënshkruar dhe shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

Prëtar i vetëm i kapitalit themeltar të shoqërisë, është shoqëria "GENERAL CEMENT" S.p.a, me qendër në Milano 11, 20123, Itali, me adresë Via Privata Maria Teresa 11 dhe kapital themeltar 200.000 (dyqindmijë) Euro.

Kapitali i shoqërisë "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK ndahet në 2.000 (dy mijë) kuota me vlerë 1.000 (një mijë) lekë secila.

Ortaku i vetëm i shoqërisë përgjigjet për humbjet e shoqërisë në kufijtë e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

### Neni 8

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie dhe janë lirisht të transferueshme midis bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve, si dhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve.

Me përjashtim të transferimit me rrugë trashëgimie kuotat mund të transferohen tek të tretët që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nëpërmjet vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë, ose në rast se shoqëria ka më shumë se një ortak, me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar, në bazë të procedurave të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

### Neni 9

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria fiton zotësinë juridike me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, si person juridik, ndërsa e ushtron aktivitetin ekonomik pas regjistrimit në organin tatimor.

Emërtimi i Shoqërisë, forma, kapitali themeltar dhe emri i administratorëve të saj duhet të figurojnë në të gjitha dokumentet e nxjerra prej shoqërisë dhe që u drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen [Shoqëria Tregtare "General Cement Albania" Sh.p.k.].

### Neni 10

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve/Ortak i Vetëm;
2. Administratorët e shoqërisë.

## Neni 11

### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË ORTAKËVE (ORTAKUT TË VETËM)

Asamblese rregullisht të formuar i jepen të gjitha kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në

## Neni 12

### KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Administratorët kanë autoritetin të administrojnë shoqërinë, me përjashtim të veprimtarive të mëposhtme, që mbeten kompetencë e asamblesë së ortakëve:

- Pjesëmarrja ose heqja dorë nga pjesëmarrja në ndërmarrje ose degë ndërmarrjesh, blerje, themelim ose shitje e një shoqërie të re dhe propozimi për bashkim, ndarje, dhënie e të ngjashme;
- Miratimi vjetor i bilancit, politikave tregtare dhe planeve të investimit;
- Të emërojë dhe të shkarkojë administratorët;
- Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll- revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej tij;
- Të miratojë llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar;
- Të vendos lidhur me ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- Të vendos për zmadhimin, apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Të vendos për të kaluar në likuidim të parakohshëm shoqërinë, ose për të zgjatur afatin;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Shoqëria administrohet nga katër ortakë, të cilët janë persona fizikë dhe ushtrojnë të njëjtat funksione për tre vite ushtrimorë dhe janë të riemërueshëm.

Administratorët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për të gjithë aktet që janë kompetencë e tyre, të cilat ushtrohen veçmas, me përjashtim të lëndëve, të treguara si më poshtë, që mbeten kompetencë e katër administratorëve bashkërisht:

1. miratimi i buxhetit vjetor, i politikave tregtare dhe i planit të investimeve vjetore;
2. hartim i politikave të financimit dhe vendimet mbi garancitë dhe huatë që kalojnë 500.000 (pesëqind mijë) Euro së bashku;
3. çdo investim me shumë më të lartë se 500.000 (pesëqind mijë) Euro dhe çdo investim i natyrës imobiliare, si në formën e fitimit të pronësisë, si në formën e qirasë financiare;
4. nënshkrimi i marrëveshjeve të tipit *joint-venture*;
5. dhënia e opsioneve mbi çdo veprimtari të "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK ose të shoqërive ku ajo është pjesëmarrëse;

6. dhënia në peng ose hipotekë e çdo veprimtarie ose dhënia e garancive të tretëve;
7. propozimet asamblesë në lidhje me destinimin e fitimit të ushtrimit dhe shpërndarjen e rezervave;
8. propozimet asamblesë në lidhje me zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. drejtimi i çështjeve gjyqësore që përfaqësojnë një rrezik që tejkalon 500.000 (pesëqind mijë) Euro, me përjashtim të rastit të pamundësisë së administratorëve;
10. të drejtën e votës në asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërive ku është pjesëmarrëse.

Administratorët emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Kompensimet e administratorëve përcaktohen nga asambleja e ortakëve.

Administratorët mund t'ia delegojnë kompetencat e veta një një ose disa personave duke përcaktuar kohëzgjatjen dhe kufijtë e delegimit.

Secilit prej administratorëve mund t'i ngarkohen funksione ose detyra të veçanta.

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e administratorëve dhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Kufizimet e kompetencave të administratorëve të caktuara në statut duhet të respektohen nga të tretët. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund t'a injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna.

Administratorët e shoqërisë duhet të kryejnë funksionet e tyre me ndershmëri, kujdes dhe të veprojnë në interesin më të mirë të shoqërisë dhe ortakëve.

Administratorët duhet të japin në kohë informacion të plotë dhe të saktë mbi veprimtarinë e shoqërisë, gjendjen financiare dhe praktikat qeverisëse.

Ata duhet të njoftojnë menjëherë me shkrim asamblenë e ortakëve konflikt interesash me shoqërinë.

Administratorët duhet të respektojnë konfidencialitetin mbi çështje që kanë të bëjnë me shoqërinë.

### Neni 13 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

Asambleja e ortakëve në këtë mbledhje emëron si administratorë të shoqërisë :

1. Z. Mana Mauro, i lindur në Cavallermaggiore, më 3 shkurt 1945, banues në Cavallermaggiore, Via delle Antiche Mura 21, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr 498537 Z;



2. Z. Gianfranco Tonon, i lindur në Colle Umberto, më 8 janar 1951, banues në Colle Umberto (TV), Via dei Fioretti 17, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. Y438674;
3. Z. Leonardo Acri, i lindur në Rossano (Bologna), më 15 janar 1951, banues në Via Domenico Aimò nr.2, Bologna, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. B 149276;
4. Z. Michele Valente, i lindur në Foggia, më 15 shkurt 1945, banues në Treviso, Vicolo Duomo nr. 3, në zotërim të pasaportës së zakonshme nr. B 283677;

#### **Neni 14** **PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK përfaqësohet nga katër administratorët, sipas modaliteteve të parashikuara në Nenin 12 të këtij statuti.

Në kufijtë e kompetencave që ky statut dhe ligji i njeh administratorëve, këta të fundit mund të delegojnë kompetencat e tyre tek të tretët për përmbushjen e akteve të veçantë.

#### **Neni 15** **MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës në Shoqërinë Tregtare "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen me kontratë pune, zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat e ligjet në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore për të gjithë të punësuarit në Shoqëri, ndërsa këta të fundit janë të detyruar të pranojnë kushtet konform këtij Statuti të Shoqërisë.

#### **Neni 16**

Të punësuarit në Shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit për moszbatimin e detyrave të caktuara, si dhe për dëmet që ata i shkaktojnë Shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative për moszbatimin e detyrave të tyre.

#### **Neni 17**

Mosmarreveshjet e të punësuarëve me Shoqërinë zgjidhen nga Gjykata shqiptare. Kur pala ankuese është person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi i përcaktuar në kontratën e punës.

#### **Neni 18** **KONTROLLI I BRENDSHËM**

Kontrulli i shoqërisë bëhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të zgjedhur nga lista e institutit të ekspertëve. Në emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar duhen mbajtur parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e parashikuara nga ligji nr. 7638, dt. 19/11/1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Eksperti i parë kontabël i autorizuar i shoqërisë emërohet Znj. Shpresa Berçani, me licencë nr. 143, e lëshuar më datë 29.12.2006.

## **Neni 19 BILANCI DHE TË ARDHURAT**

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, administratorët i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Administratorët përgatisin raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të kaluar, ndyshimet e parashikuara në të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes së ushtrimit financiar deri në datën e hartimit të raportit si dhe veprimtaritë e shoqërisë në fushën kërkimore.

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurive dhe veprimtari së saj, në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbyllje të ushtrimit të vitit financiar, administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratori, i nënshtrohen miratimit të asamblesë së ortakëve (ortakut të vetëm) brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacion i plotë i saj, dokument themeluese të Shoqërisë, si dhe dokumentet që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike të Shoqërisë, me të gjitha ndryshimet e bëra deri në ditët e fundit.

## **Neni 20 REZULTAT E USHTRIMIT DHE ÇAKTIMI I FITIMIT**

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci i miratuar, pasi të jetë tërhequr shuma jo më e ulët se pesë përqind për rezervën ligjore deri sa kjo të ketë arritur një të pestën e kapitalit shoqëror, shpërndahen në mënyrën që vendos asambleja.

Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk bëhet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividendi, në qoftë se kapitalet e veta do të bëheshin më të vogla se shuma e kapitalit themeltar, plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e

domosdoshme. Në qoftë se ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimeve të ardhshme deri në shuarjen e saj.

Pagesat e dividendëve kryeht në afatin e caktuar dhe pranë kasave të caktuara çdo vit nga administratorët.

### **Neni 21 SHPËRBËRJA E SHOQËRISË**

Në çdo kohë dhe për çdo shkak shpërbërjeje të shoqërisë, asambleja vendos modalitetet e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidator duke përcaktuar kompetencat në respekt të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 7638 "Për shoqëritë tregtare" dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 22 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë Statut, referencë do të jenë vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë si dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

### **Neni 23**

Ky statut përpilohet në katër kopje për:


- a. Gjykatën e Rrethit Gjygjësor Tiranë, për të bërë veprimet në Rregjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik të kësaj Shoqërie;
- b. Për Zyrën e Tatimeve, për marrjen e certifikatës së rregjistrimit në organin tatimor;
- c. Zyrën e Noterisë;
- d. Një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare "GENERAL CEMENT ALBANIA" SHPK.

### **ORTAKU I VETËM SHOQËRISË TREGTARE**

Shoqëria "GENERAL CEMENT" SPA

**Përfaqësuar nga**

**Z. Michele Valente**



**Administrator i deleguar**